

# **RAPORTI FILLESTAR**

(INCEPTION)

PPV E BASHKISE GRAMSH

PËRGATITUR NGA METROPOLIS

TIRANË, GUSHT 2017

## Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje.....	4
2. Metodologjia.....	4
2.1. Faza përgatitore.....	4
2.2. Vlerësimi dhe Analizat .....	5
2.3. Faza e Strategjisë së Zhvillimit të Territorit .....	6
2.4. Plan i Zhvillimit të Territorit dhe Rregullorja e Zhvillimit.....	7
2.6. Vlerësimi Strategjik Mjedisor .....	9
2.7. Procesi i Miratimit të PPV .....	10
2.8. Mbledhja e të dhënave .....	10
2.9. Rolet dhe Përgjegjësitë .....	11
2.10. Dorëzimet.....	12
2.11. Koordinimi.....	12
3. Progresi i Punës dhe Strategjia e Ardhshme .....	13
4. Detaje të përputhshmërisë .....	14
5. Përmbledhje .....	15
6. Shtojca.....	15

**Shkurtime**

PIK Plan i Investimeve Kapitale

VKM Vendim i Këshillit të Ministrave

GIS Geographical Information System

PPV Plani i Përgjithshëm vendor

PPKT Plan i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit

FKV Forumi Këshillmor Vendor

PDV Plan i Detajuar Vendor

PBA Plani Buxhetor Afatmesëm

MZHU Ministria e Zhvillimit Urban

KKT Këshilli Kombëtar i Territorit

AKPT Agjencia Kombëtare e Territorit

PSZH Plani Strategjik i Zhvillimit

## **1. Hyrje**

Bashkia Gramsh është e pozicionuar në rajonin qendror të Shqipërisë. Bashkia Gramsh, me një sipërfaqe prej 737 km<sup>2</sup>, ka qendrën urbane, qytetin e Gramshit, si një qendër administrative. Ajo kufizohet në veri me bashkinë Elbasan, në jug me bashkinë Skrapar, në jug-lindje me bashkinë Maliq, në lindje me bashkinë Pogradec, dhe në perëndim me bashkitë Cërrik, Berat dhe Kuçovë. Pas reformës administrative dhe territoriale, bashkisë bërthamë (të vjetër) të Gramshit iu bashkëngjiten edhe 9 (nëntë) njësi të tjera administrative (ish-komuna), përkatësisht: Kodovjat, Kukur, Kushovë, Lenie, Pishaj, Poroçan, Skërnderbegas, Sult dhe Tunjë.

Bujqësia dhe blegtoaria janë sektorët kryesorë që udhëheqin zhvillimin ekonomik lokal të bashkisë. Vreshtaria, ullishtet dhe dru-frutorët janë potenciali në sektorin e buqësisë. Ndërkohë vitet e fundit, një potencial të vërtetë paraqet zhvillimi i ekoturizmit pasi territoret ku shtrihet bashkia Gramsh, paraqesin një pasuri të madhe të burimeve natyrore dhe trashëgimisë historiko-kulturore për sa i përket atraksioneve turistike, të shpërndara pothuajse në gjithë njësitë administrative. Peisazhi i Gramshit, përveç ulje ngritjeve të kodrave dhe maleve të shumtë në numër, përshkohet nga lumi Devoll, i cili është burimi më i rëndësishëm hidrik për territorin. Në vitet e fundit peisazhi ka pësuar një ndryshim drastik me ndërtimin e hidrocentralit të Banjës.

Bashkia Gramsh ka një pozicion strategjik përsa i përket lidhjes perëndim-lindje. Gramshi ndodhet në një distancë prej 82 km larg nga Tirana, 41 km larg nga qyteti i Elbasanit dhe 67 km larg nga qyteti i Korçës dhe është pjesë e qarkut të Elbasanit. Duke qenë në qendër të këtij rajoni, Bashkia Gramsh shihet si një nyje e rëndësishme për të forcuar lidhjet mes koridoreve të rëndësishme ekonomike dhe natyrore me karakter bujqësor, turistik dhe shërbimesh (Elbasan-Tiranë-Durrës-Lushnje-Fier dhe Pogradec- Korçë-Skrapar-Berat).

## **2. Metodologjia**

Për të krijuar një panoramë më të qartë për hapat që duhet të ndiqen me qëllim përgatitjen me sukses të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Gramsh, procesi është ndarë në 6 faza kryesore, siç është përshkruar dhe në Termat e Referencës dhe kontratën me MZHU. Secila nga fazat dhe aktivitetet përbërëse të tyre shpjegohen më poshtë.

### **2.1. Faza përgatitore**

Është e rëndësishme që faza përgatitore të nisë me formimin e grupit të punës. Së bashku me Bashkinë (Kryetarin si udhëheqës të planit dhe Drejtorinë e Planifikimit) duhet të krijohet një grup pune i përbërë nga stafi i bashkisë dhe ekspertë të palës konsulente. Ndërkohë që pala konsulente ka ngritur ekipin e ekspertëve, një ekip prej rreth 15 personash duhet të ngrihet edhe nga stafi i Bashkisë Gramsh.

Gjatë kësaj faze, bashkia dhe grupi konsulent do të duhet të rishikojnë dhe të nxisin krijimin e Forumit Këshillmor Vendor. Krijimi i Forumit Këshillmor Vendor, siguron një mbulim mjaft të mirë të interesave të qytetarëve të Bashkisë Gramsh dhe të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, për të gjitha njësitë administrative, tashmë përbërëse të bashkisë së madhe Gramsh.

Stafi i Bashkisë Gramsh, siguron se çdo njoftim, dhe material i hartuar në kuadër të Planit të Përgjithshëm Vendor, do të afishohet në faqen zyrtare të bashkisë dhe në rrjete sociale.

Forumit Këshillmor Vendor parashikohet të formohet, gjatë dëgjësës së parë Publike, për Miratimin e Nismës, në Bashkinë Gramsh.

Shqyrtimi i konteksti lokal është i rëndësishëm për disa arsye:

- Nëpërmjet shqyrtimit të planeve të mëparshme dhe dokumenteve të hartuara së fundmi, grupi konsulent do të sigurojë kalimin nga draft Strategjia e Zhvillimit të Territorit në PPV, si dhe do të mundet të rishikojë dhe disa pika të Planit Buxhetor Afatmesëm.
- Nëpërmjet shqyrtimit krijohet një kuptim i përbashkët mbi sasinë dhe cilësinë e informacionit që është i disponueshëm
- Të bihet dakord mbi planin e aktiviteteve dhe përgjegjësitë e secilës palë, veçanërisht në ato pika kur kërkohet përpunimi i informacionit në formë dixhitale (apo hartografike)
- Siguron që të gjithë ekspertët në grupin e punës të kenë njohuri të barabarta mbi dokumentet e mëparshme të planifikimit dhe të vendosin së bashku pikat të cilat kanë qënë të sukseshme në planet e mëparshme dhe mund të rimerren sërish në hartimin e PPV-së
- Të evidentohet lista e institucioneve të cilat duhet të kontaktohen.

AKPT, gjithashtu do të mundësojë Bashkisë Gramsh dhe palës konsulente një pjesë të informacionit që është në dispozicion për Bashkinë Gramsh.

Çdo vendimarrje gjatë këtij procesi, si rishikimi i Forumit Këshillmor Vendor, Vendimi mbi marrjen e Nismës, do të botohen në regjistër, sipas përcaktimeve të ligjit.

Në përfundim të kësaj faze, Bashkia Gramsh do të dërgojë një shkresë zyrtare drejtuar Ministrisë së Mjedisit për fillimin e procedurave të hartimit të dokumentit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, e cila do të botohet në regjistrin e territorit.

Gjatë kësaj faze mund të mbahet një takim informues mes dy ekipeve të punës për të dakordësuar bashkarisht rolet dhe përgjegjësitë.

## **2.2. Vlerësimi dhe Analizat**

Kjo fazë, përcakton dhe bazën për vazhdimësinë e punës në hartimin e PPV-së. Vizioni i së ardhmes, objektivat strategjike, programet, dhe të gjitha propozimet e tjera formulohen mbi bazën e një analize të mirë dhe të thelluar të territorit dhe komponentëve përbërës të tij. Megjithëse pjesa më e madhe e informacionit është mbyllur në fazën përgatitore të projektit, analizat mund të pasurohen edhe më shumë me gjetje të tjera gjatë kësaj faze.

Dorëzimet për këtë fazë, në një farë mënyre janë të përcaktuara nga ligji (në VKM 671). Kjo fazë do të konkludojë me Analizën e Theluar të Territorit, Databazën e GIS dhe Analizën e Metabolizmit të Territorit.

Të gjitha aktivitetet e kësaj faze do të konkudojnë me përgatitjen e draftit të analizës së thelluar të territorit. Lista e analizave të thelluara janë përcaktuar në VKM 671 në nënin 53 të saj. Siç përcaktohet edhe në Rregulloren e Planifikimit analizat e PPV hartohen në dy faza të rëndësishme:

- Analiza e Metabolizmit të territorit, e cila ndodh më shpejt në kohë dhe është një nga pikat më të rëndësishme të Strategjisë së Zhvillimit
- Analiza e Thelluar e Territorit, e cila kërkon krijimin e një baze të saktë, të plotë dhe të përditësuar të dhënash, dhe që do të udhëheqë Planin e Përgjithshëm Vendor.

Në këtë fazë, peshë të veçantë zë edhe analiza e thelluar e gjendjes së Mjedisit, e cila do të hartohet mbështetur në informacionet si më poshtë:

- Raportet e SHGJSH-së, përgatitur në nivel Qarku të cilat përmbajnë informacione për hidrologjinë, aktivitetin sizmik, riskun gjeologjik, topografinë, studime të menaxhimit të basenit për Lumin Devoll etj. Hartat e SHGJSH mundësohen në shkallë 1:100,000.
- Hartat topografike, janë të dukshme në portalin e ASIG të cila
- Hartat mbi zonimin mikrosizmik, thuajse nuk ekzistojnë për territorin e Shqipërisë megjithatë, zonimi makrosizmik është i mundësuar dhe mund të përdoret për qëllimin e analizës
- Informacioni mbi zonat e mbrojtura është i mundësuar në platforma online, por i pamundur për tu shkakuar. Në supozojmë që AKPT apo edhe bashkia do të mundësojë një version të editueshëm.
- Informacione të tjera rreth klimës do të bëhen të mundura grupit konsultues gjithashtu nga AKPT/Bashkia
- Informacioni mbi kategoritë e tokës (boniteti dhe fertiliteti), është një element kyç në vendimarrjen e PPV-së. Një informacion i tillë mund të merret nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore-Fushë Krujë, apo drejtoritë bujqësore në Qark. Megjithatë ky lloj informacioni, në dijeninë tonë, nuk është i dixhitalizuar në asnjë lloj forme (pra ekziston vetëm në "hardcopy"). Në rastin më të mirë Bashkia mund të marrë hartën e vjetër kadastrale dhe një libër të dhënash të cilat lidhin numrat e parcelave me kategorinë përkatëse të bonitetit të tokës. Megjithëse informacioni nuk është i përditësuar ai do të ndihmojë në vendimarrjen lidhur me konvertimet mbi tokënbujqësore (nëse do të ketë). Në mungesë të këtij informacioni, çdo kërkesë e Bashkisë për të konvertuar tokënbujqësore do të mbetet një draft, dhe KKT do të vendosë mbi bazën e sipërfaqës që propozohet për konvertim. Kjo çështje bëhet e pashmangshme në rastin kur legjislacioni në fuqi për tokat bujqësore, vendos rregulla strikte dhe të panegociueshme mbi ruajtjen e tokave bujqësore në të gjithë territorin e Shqipërisë.
- Territori i Gramshit mbart një sërë pikash turistike dhe atraksionesh natyrore me vlera të paçmueshme, si Ujëvara e Sotirës, Kanioni i Holtës dhe Shkëmbi I Kabashit, Liqeni I Dushkut, fshati Grabovë e Sipërme, Kalaja e Irmajit etj. Ekipi konsultues me mbështetjen e plotë të Bashkisë Gramsh, do të ndërmarrin një sërë vizitash në terren mbi bazën e të cilave do të krijohet inventari mjedisor, me gjetjet, analizat dhe vlrësimin e kushteve aktuale të cilat do të jenë pjesë e integruar si e PPV ashtu edhe pjesë e dokumentit të VSM.

### **2.3. Faza e Strategjisë së Zhvillimit të Territorit**

Çdo Qeveri Vendore ka të drejtën të përgatisë Dokumentin e Zhvillimit Strategjik, dokument i cili mund të variojë nga një Strategji Zhvillimi deri në një Plan të Zhvillimit Ekonomik Vendor. Pavarsisht se titulli i dokumentit mund të variojë, metodologjia e përgatitjes së tij mbetet e pandryshuar, ndërkohë që fokusi mund të orientohet më shumë drejt zhvillimit social ekonomik dhe zhvillimit të territorit. Si është

përmendur edhe më parë Bashkia Gramsh ka në dispozicion një sërë dokumentesh si Planit Operacional I Zhvillimit miratuar në vitin 2016. Puna për hartimin e PPV-së do të nisë pikërisht nga këto dokumente të hartuara së fundmi.

Planet fizike nuk mund të jenë instrumente të forta menaxhimi nëse nuk do të mbështeten në vendime të forta strategjike. Qeveria Shqiptare ka vendosur ti japë planeve trritoriale edhe një dimension strategjik, duke mbivendosur në këtë mënyrë procesin e planifikimit strategjik me atë të planit rregullator të territorit. Për këtë arsye hartimi i PPV-së mbart tashmë të dy komponentët: Strategjinë E zhvillimit të Territorit dhe Planin Rregullator.

Duke iu referuar ligjit të planifikimit të territorit (neni 52 në VKM 671), strategjia e territorit do të përmbajë si më poshtë:

- Vizionin Strategjik të Zhvillimit të Territorit
- Objektivat Strategjike të zhvillimit dhe programet e zhvillimit të lidhura me to
- Planin e Veprimeve për zbatimin dhe prioritarizimin e projekteve strategjike
- Indikacionet për investimet Kapitale
- Ndryshimet e pritshme në sistemin e Territorit (urban, bujqësor, natyror, hidrik dhe infrastrukturor)
- Vizualizimin (nepermjet hartave) të Vizionit Strategjik

Draft Strategjia e Zhvillimit përmban të gjithë komponentët sa më sipër. Bashkia së bashku me palën konsulente do të rishikojnë këtë dokument vetëm me qëllimin e thellimit të analizave dhe objektivave Strategjike.

Grupi i punës do të përgatisë fishat e projektit të cilat do të nxisin zbatimin e objektivave strategjike dhe programeve respektive.

Në këtë pikë, grupi konsulent do të duhet të punojë ngushtësisht me departamentin e financës në Bashkinë Gramsh, për analizimin e situatës fiskale në bashki, dhe për projektimet e para mbi Planin e Investimeve Kapitale

#### **2.4. Plan i Zhvillimit të Territorit dhe Rregullorja e Zhvillimit**

Faza e tretë përfshin një sërë aktiviteteve me një natyrë teknike strikte, me qëllim përmbushjen e kërkesave të rregullores së planifikimit (neni 54, 55, 56 dhe 57 i VKM nr. 671).

Përmbajtja e Planit të Zhvillimit të Territorit përcaktohet në nenin 54 të rregullores (VKM 671). Ky është një moment kyç për rishikimin e planeve të mëparshme veçanërisht parashikimeve të Planit Operacional. Për përgatitjen e planit të propozuar të tokës, përfshirë këtu propozimet mbi rrjetin infrastrukturor, sikurse dhe ndarjen e propozuar të 5 sistemeve, grupi i punës do të mbështete në Vizionin Territorial të Zhvillimit, objektivave dhe projekteve strategjike si dhe qendërsive dhe fashave të zhvillimit të territorit.

Në planin e propozuar të përdorimit të tokës do të punohet fillimisht me përcaktimin e 14 kategorive bazë të përdorimit, siç përcaktohen dhe në nenin 77 të Rregullores së Planifikimit – VKM nr.671. Më pas do të vijohet puna me përcaktimin e nënkategorive kryesore, dhe funksioneve përkatëse.

Veç përcaktimit të propozimeve në përdorimin e tokës, dhe ndarjen e propozuar të 5 sistemeve, bazuan në studimin mbi tipologjitë hapsinore të territorit, analizë kjo e cila do të kryhet në fazën e dytë), ekipi konsulent do të ndajë territorin në njësi strukturore. Pas përfundimit të ndarjes së njësive strukturore, ekipi konsulent, në bashkëpunim me bashkinë do të përcaktojnë kushtet dhe koeficientët e zhvillimit për secilën njësi.

Nëni 56 i Rregullores së Planifikimit (VKM 671) përcakton strukturën dhe përmbajtjen minimale të elementëve që duhet të përfshihen në Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Të Territorit për Bashkinë. Rregullorja do të përcaktojë kushtet e zhvillimit, kushtëzimet ligjore për përdorimet e tokës, sistemet e territorit, infrastrukturës, hapësirave publike dhe sigurisht kushtet për secilën njësi strukturore. Kapitujt mbi sistemin e territorit dhe kategoritë e përdorimit të tokës do të jenë më të përgjithshme në strukturë dhe do të përcaktojnë rregulla sektoriale ndërkohe që rregullat dhe kushtëzimet për secilën njësi strukturore do të jenë të detajuara në formën e pasaportave për secilën njësi strukturore.

Në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, masat për mbrojtjen e mjedisit, janë pjesë si e VSM po aq edhe e dokumentit të PPV. Duhet të theksojmë se ky plan do të përmbajë gjithashtu dhe një analizë të peizazhit dhe masave që duhen marrë për mbrojtjen e tij me qëllim përmirësimin e situatës ekzistuese.

Plani për mbrojtjen e mjedisit propozon dhe sugjeron gjithashtu masa për hapësirat e gjelbërta publike, parqet periferike, korridoret e gjelbërta në zonat natyrore dhe jo vetëm, dhe çdo lloj forme tjetër të hapësirave publike. Së fundmi, plani për mbrojtjen e mjedisit do të luajë rol të rëndësishëm në përcaktimin e masave për mbrojtjen e burimeve ujore dhe zonave ripariene, tokës bujqësore nga rreziku i përmytjeve dhe rrëshqitjeve, minimizimin e efekteve negative të pikave të nxehta mjedisore etj, me qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe ruajtjen e vlerave natyrore dhe peizazhiste në Bashkinë Gramsh.

Të gjitha propozimet sa më sipër do të evidentohen edhe në material hartografike si përcaktohen dhe në VKM nr.671.

Në përfundim të kësaj faze, grupi konsulent në bashkëpunim me Bashkinë do të hartojnë Planin e veprimeve për zbatimin e PPV. Ky plan është një vazhdim dhe bazohet në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të hartuar më herët gjatë procesit.

Të gjitha dokumentet e hartuara në këtë fazë (harta dhe tekst) do të publikohen në kohë në Regjistrin e Integruar të Territorit, së bashku me ftesat për dëgjuesat publike që ndjekin këtë fazë të procesit të Planit.

## **2.5. Raporti për ngritjen e Kapaciteteve**

Si përfundim, që nga fillimi i projektit, pala konsulente do të mbështesë Bashkinë në zhvillimin e kapaciteteve planifikuese. Një vlerësim i shpejtë i burimeve njërëzore dhe paisjeve për të zhvilluar punën e PPV do të ndodhë që në fazën përgatitore dhe do të vendosë bazat për kooperimin ndërmjet palës Konsulente dhe stafit bashkiak, në një grup të përbashkët pune. Ky vlerësim do të vendosi bazat për raportin final të kapacitetit ndërtues. Kjo do të sigurojë palën konsulente me një kuptim më të madh të kontekstit të burimeve njërëzore, lehtësimeve paisjeve teknike dhe aftësive profesionale.

Pala konsulente do të mbledhë të gjithë informacioni bazë përmes intervistave kyçe dhe kooperimit me stafin bashkiak gjatë procesit të PPV. Do të ketë mbikëqyrje të punës së përditshme dhe në bazë të rast pas rasti. Në fund, pala Konsulente do të vlerësojë nevojat e burimeve për departamentin e propozuar të planifikimit psh: hapësirë zyre, kompjutera dhe paisje të tjera, transport, buxhet etj. Bazuar në



rezultatet e vlerësimit, pala konsulente do të përgatisë një raport të shkurtër me rekomandime dhe sugjerime në:

1. Vendosjen e procedurave për zbatimin e PPV sipas planit të veprimit dhe fazave të PPV
2. Ndërtimi i aftësive të stafit (aftësi teknike dhe profesionale- trajnime, ëorkshope, kurse etj.)
3. Ndërtimi i aftësive të folurit në publik
4. Ndryshime të mundshme në strukturën institucionale dhe procedurat organizuese
5. Modifikimin e buxhetit për departamentin e planifikimit
6. Tarifa të reja të cilat mund të prezantohen për të rritur buxhetin e departamentit për shërbime të planifikimit;

Një shembull i Inventari për Ngritjen e Kapaciteteve është i bashkëngjitur me këtë dokument në ankes.

## **2.6. Vlerësimi Strategjik Mjedisor**

Proçesi i VSM do të nisë menjëherë pas aprovimit të iniciativës për PPV, siç kërkohet nga Ligji NR. 91/2013, datë 28.02.2013 “Mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, ashtu edhe për nevojë për formulimin e saktë për një analizë ambienti (mbrojtje dhe zhvillim). Hapat procedurialë për hartimin e VSM janë të përcaktuar në ligjin nr. 91/2013. Nevoja për VSM është e justifikuar nga kërkesat e ligjit të planifikimit nr. 107/2014 dhe reformën territorial-administrative. Konsultimet publike të VSM janë parashikuar në dy sesione të dedikuara, ashtu si edhe diskutimi për çështjet e mjedisit gjatë sesioneve të diskutimeve publike të PPV. Më poshtë, është një përmbledhje e proceseve teknike për hartimin, finalizimin dhe publikimin e Raportit të VSM:

- Përmbyllja e Qëllimit të Studimit; Dakortësimi mbi objektivat e VSM, mbledhja e informacionit të nevojshëm, së bashku me aktivitetet e Fazës 1.
- Krijimi i inventarit të VSM dhe analizimi i informacionit së bashku me aktivitetet e Fazës 1 dhe 2 (dëgjesa publike për këtë fazë do të kombinohet me me dëgjësën e PPV).
- Informacion në cilësinë dhe ndotjen e ajrit, duke përfshirë ndotjen akustike dhe eburimet e ndotjes (industria, trafiku, mbetjet, industria e ndërtimit, radiacioni, etj.)
- Informacioni mbi cilësinë dhe ndotjen e tokës (përdorimi, mbetjet, erozioni, pikat e nxehta mjedisore etj.)
- Cilësia dhe ndotja e ujit (ujësjellës dhe kanalizime, mbetjet e ngurta, uji i pijshëm, ujë për vaditje, sistemi i kullimit, erozioni lumorm pikat e nxehta mjedisore dhe ndikimi në ujë, etj.)
- Bujqësia (niveli i zhvillimit, teknologjitë, përdorimi, ndotja e tokës, etj.)
- Biodiversiteti (eksishtimet dhe habitatet, zonat dhe specie e mbrojtura, etj.)
- Peisazhi dhe zonat e mbrojtura.
- Shërbimet Publike (ujësjellës, kanalizimet, kullimi dhe vaditja, mbetjet e ngurta, gjelbërimi dhe punimet për zbulimin e qytetit).
- Vlerësimi i propozimeve të PPV për performancën mjedisore dhe ndikimet. Vlerësimi do të rezultojë në rekomandime për modifikime dhe përmirësime të propozimeve për performancë të kënaqshme mjedisore.

Hartimi i Raportit të VSM, duke përfshirë planin e monitorimit dhe hartimin e konsiderimeve mjedisore dhe masave zbutëse. Ky raport do të përfshijë gjithashtu edhe planin për mbrojtjen mjedisore të PPV. Vemendje e veçantë do të kushtohet propozimeve që merren me pikat e nxehta mjedisore/industrial. Pala Konsulente do të identifikojë pikat e nxehta mjedisore përmes studimeve të UNDP mbi këtë çështje, por gjithashtu mund të vendosë të përfshijë pika të tjera vendore të nxehta, bazuar në analizën vendore mjedisore në kuadër të PPV.

## **2.7. Procesi i Miratimit të PPV**

Pas hartimit të dokumentit përfundimtar të PPV-së, Bashkia do ta dorëzojë atë në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, për shqyrtim, vlerësim dhe marjen më pas të Aktit të përpunueshmërisë (si përcaktohet në rregulloren e planifikimit).

Gjatë kohës që AKPT, do të jetë duke vlerësuar PPV-në, pala Konsulente do të asistojë Bashkinë në përgatitjen e prezantimeve të PPV-së për Miratimin në Këshillin Bashkiak dhe në Këshillin Kombëtar të Territorit më vonë.

Parashikohet që AKPT do të sjellë disa komente të cilat do të reflektohen menjëherë nga stafi i Bashkisë dhe ekipi konsulent, përpara miratimit të këtij dokumenti në Këshillin Bashkiak.

Në përfundim të këtij procesi, ekipi konsulent do të kryejë dhe të gjitha printimet e dokumenteve dhe hartave që nevojiten për procedurën e miratimit në Këshillin E Bashkisë dhe KKT.

Dokumentet finale do të publikohen në Regjistrin e Integruar të Territorit.

## **2.8. Mbledhja e të dhënave**

Vështirësia më e mëdhe që do të hasë grupi i punës gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor është mbledhja e të dhënave të sakta dhe të përditësuara për çështjet që do të trajtohen nga PPV. Është shumë e rëndësishme që pjesa më e madhe e të dhënave të disponohet (dhe përpunohet) në formatin GIS, ndërkohë që pjesa tjetër mund të organizohet në formatet excel dhe word.

Një listë me informacionin paraprak të kërkuar është bashkangjitur si shtojcë në këtë dokument.

Si pala përfituese e projektit, Bashkia Gramsh duhet të mundësojë gjetjen e informacionit, ndërkohë që administratorët e njësive do të jenë personat kyç të cilët lehtësojnë gjetjen dhe marrjen e këtij informacioni. I gjithë informacioni i mbledhur gjatë fazës përgatitore do të procesohet në sistemin GIS në shkallën më të detajuar të mundshme, brenda afatit të caktuar kohor dhe disponueshmërisë së informacionit nga ana e ekipit konsulent.

Pavarsisht se një pjesë e madhe e informacionit gjendet në Bashinë Gramsh, është e nevojshme që institucionet e tjera qendrore (ministritë, drejtoritë rajonale etj) të vënë në dispozicion informacione të tjera shtesë dhe në mbështetje të Planit të Përgjithshëm Vendor. Për këtë qëllim, institucioneve do tu kërkohet informacioni sipas rastit nëpërmjet rrugëve zyrtare dhe shkresave të cilat do të nisën nga Bashkia Gramsh. Në shtojcën bashkangjitur këtij dokumenti do të mund të gjeni dhe një kopje shembull të një shkrese zyrtare që do të dërgohet institucioneve

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, Ekipi konsulent, do të mbajë një sërë trajnimesh gjatë procesit të punës (on job) me Bashkinë Gramsh, si dixhitalizimi i përdorimit të tokës, hedhja e të dhënave në platformën GIS etj.

Indikatorët të cilët masin suksesin dhe performancën për mbylljen e këtij aktiviteti janë:

- Mbledhja e informacionit nga Bashkia Gramsh dhe institucionet e tjera të niveli qendror, e raportuar përmes letrave zyrtare
- Krijimi i databazës së plotë të GIS

## **2.9. Rolet dhe Përgjegjësitë**

Bashkia Gramsh është përgjegjëse për pikat si mëposhtë:

- Mbledhja e të dhënave
- Organizimi dhe lehtësimi i punës në terren
- Hedhja e të dhënave në AutoCAD/GIS apo formate të tjera
- Prezantimi i pjesëve përbërëse të PPV para publikut siç përcaktohet në secilën fazë
- Lehtësimi i komunikimit me institucionet e tjera publike, biznese, qytetarë dhe palëve të interesuara
- Publikimi i dokumenteve të nevojshme të RIT, të koordinuara me AKPT
- Dërgimi i PPV në fazat e aprovimit.

Një rol kryesor do të luhet nga administrata e Bashkisë Gramsh, e cila do të përfshihet në të gjithë proceset e implementimit të PPV, veçanërisht gjatë fazës përgatitore dhe mbledhjen e të dhënave.

Pas aprovimit të Nismës nga Këshilli Bashkiak, grupi i punës do të përcaktohet më Urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Grupi do të drejtohet nga Drejtori i Zyrës së Planifikimit, i cili është përgjegjës për shpërndarjen e detyrave në grupet e punës, duke vlerësuar progresin e arritur, dhe organizimin dhe asistimin në mbledhjet ndërmjet grupeve të Konsultimit dhe grupit që punon nga Bashkia.

- Nga ana tjetër, Pala Konsulente është përgjegjëse për:
- Pjesëmarrëse në punë në terren dhe mbledhja e informacionit sa herë që është e mundur
- Ndërtimin e bazës së GIS dhe popullimin e saj me të dhëna
- Hartimin e propozimit dhe kryerjen e hartave të analizës së thelluar
- Përgatitjen e prezantimeve për konsultimet publike, dhe në rast dakordësimi me Bashkinë dhe mbajtjen e këtyre prezantimeve
- Rishikimin e dokumenteve dhe hartave sipas komenteve
- Të komunikojë me MZHU dhe AKPT sa herë që nevojitet
- Të kryejë printimin final të të gjithë dokumenteve.

Pala Konsulente do të ndjekë gjithashtu procesin e aprovimit të PPV nga ana teknike. Sipas mandatit ligjor dhe indikime të mëtejshme në metodologjinë dhe planin e punës, Bashkia do të jetë përgjegjëse për:

mbledhjen e të dhënave, prezantimi i dëgjësive publike, komunikimi me qytetarët dhe palët e interesuara mbi çështjet me interes në kornizën e PPV, prezantimin e planit në institucione të tjera, bashkitë fqinje dhe KKT, dhe mundësimin e një komunikimi (publik dhe institucional) të lehtë dhe procesi transparent përgjatë gjithë përgatitjes së PPV. Pala Konsulente, përgjatë përfshirjes teknike në product, do të ofrojë mbështetje në këto faza të procesit, të marrë pjesë në seancat pyetësore, prezantimet draft, dhe të printojë kopje të hartave ashtu siç kërkohet në Termat e Referencës.

## 2.10. Dorëzimet

Dorëzimet e PPV dhe procesit të zbatimit të tij, do të kryhen sipas ligjit numër 107/2014.

Si specifikohet në Tabelën e Përgjithshme kohore të projektit (shiko shtojcën 1), dorëzimet sipas kontratave janë si më poshtë:

- Raporti Filestar
- Dokumenti i Strategjisë Territoriale (i aprovuar në Këshillin Bashkiak)
- Plani i Përgjithshëm Vendor, me gjithë përbërësit e tij (i aprovuar në Këshillin Bashkiak)
- Raporti mbi ngritjen e Kapaciteteve

Në lidhje me dorëzimet në përputhje me ligjin nr. 107/2014, pala Konsulente dhe Bashkia duhet të dorëzojnë si më poshtë:

- Dokumenti i Strategjisë Territoriale (para aprovimit në Këshillin Bashkiak)
- Dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendor (para aprovimit në Këshillin Bashkiak) – duke përfshirë këtu edhe Dokumentin e Planit të Investimeve Kapitale, Listën e Hartave të PPV, Dokumentin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor
- Konvertimin e databazës së PPV në formatin e kërkuar GIS

Gjatë procesit të zbatimit të PPV Bashkia dhe pala Konsulente do të mbajnë 5 (pesë) Dëgjesa Publike. Para secilës, Bashkia duhet të dorëzojë (publikojë në RIT), dokumente ppt të prezantimeve që do të mbahen, njoftimin e dëgjësës publike së bashku me një përmbledhje të shkurtër se çfarë do të diskutohet gjatë Dëgjësive Publike. Në përputhje me ligjin, Bashkia do të bëjë të tjera publikime në RIT.

*Gjithë të mësipërmet janë gjithashtu edhe tregues që Pala Konsulente dhe Grupi do të masin suksesin e zbatimit të PPV.*

## 2.11. Koordinimi

Ky koordinim përfshin dy përbërës, domethënë: marrëdhënien ndërmjet Bashkisë dhe MZHU dhe AKPT; si edhe komunikimin ndërmjet palës Konsulente dhe tre institucioneve. E para është e rregulluar sipas ligjit. E fundit është e rregulluar sipas kontratës, siç tregohet në thirrjen për propozim. Pala Konsulente do të komunikojë me AKPT, për të informuar me procesin e PPV dhe të kërkojë mbështetjen e AKPT përgjatë procesit sipas nevojës, për të siguruar një produkt të kënaqshëm. Ky komunikim në asnjë mënyrë nuk do të pengojë, ose tejkalojë komunikimin që Bashkia do të ketë me AKPT, sipas përcaktimit në ligj; në të kundërt qëllimi është për të qënë plotësues.

Mjedhje specifike do të mbahen ndërmjet Bashkisë, palës Konsulente dhe Komitetit drejtues (një komitet i posaçëm) me qëllim për të ndihmuar në zbatimin e PPV.

### 3. Progresi i Punës dhe Strategjia e Ardhshme

Gjatë Fazës Përgatitore dhe Fazës së parë të zbatimit të projektit, Bashkia Gramsh dhe pala Konsulente kanë ndërmarrë aktivitetet si më poshtë:

- Një mbledhje është mbajtur me 11 Korrik, me grupin e punës së Bashkisë dhe pjesës homologe të palës Konsulente. Kjo mbledhje u drejtua nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, i cili shkurtimisht shpjegoi nevojën për PPV, detyrat që secili do të mbajë, dhe siguroi që çdo përgjegjësi do të mbahet përgjatë gjithë procesit. Pas mbledhjes, koordinatori i grupit të palës Konsulente, shpjegoi planin e aktiviteteve (i cili ishte dërguar që më parë me e-mail tek të gjithë grupet e punës), dhe se si faza e mbledhjes së të dhënave do të kryhej. Në këtë mbledhje, të gjithë administratorët ishin prezent, dhe secili prej tyre mori listën me informacionin e kërkuar (harta dhe të dhëna të papërpunuara).
- Gjatë kësaj faze, disa intervista janë mbajtur me stafin bashkiak (drejtori i financave, drejtori i planifikimit, drejtori i shërbimeve, administrator, etj.) për shtrukturën e Raporti për ngritjen e kapaciteteve. Të dhënat e mbledhura dhe analizimi i gjetjeve do të përfshihet në dorzimin e Raporti për ngritjen e kapaciteteve si dakortësuar sipas planit të aktiviteteve. Një kopje e Inventari për ngritjen e kapaciteteve është i bashkëngjitur me këtë dokument.
- Bashkia Gramsh, ka dorëzuar tashmë të gjithë kërkesat për informacion, letra zyrtare tek të gjithë institucionet (qëndrore) dhe është akoma në pritje të përgjigjeve. Një shembull i një letre zyrtare është gjithashtu i bashkëngjitur me këtë dokument.
- Pala Konsulente ka organizuar tashmë takime specifike me administratorët dhe ka mbledhur informacion me përdorimin e tokës (4 njësi administrative në progress), me drejtorinë e pyjeve (informacioni i mbledhur, dhe procesi i digjitalizimit ka filluar) drejtorin e e Drejtorisë së Bujqësisë.
- Stafi bashkiak, po punon në hartimin në AutoCAD të të gjithë bizneseve që veprojnë në Bashkinë Gramsh. Ky aktivitet, po mbahet në mbështetje me grupin konsulent dhe mund të konsiderohet si trajnim në punë e sipër.
- Si u tha në kapitullin e sipërpërmendur, Faza Përgatitore e PPV të Bashkisë Gramsh, ka për qëllim të përfshijë në të gjithë procesin palët e interesuara. Ne kemi për qëllim të drejtojmë këtë aktivitet në dy mënyra. Si fillim, Bashkia Gramsh, do të sigurohet të publikojë të gjithë aktivitetet në kuadër të PPV në sitin e saj zyrtar, dhe në llogarinë e saj në Facebook. Çdo prezantim, i plotësuar me përfundimet e Dëgjësës Publike do të postohet në këto faqe. Personi përgjegjës për këtë veprim do të jetë zyrtari IT i Bashkisë Gramsh. Në një periudhë prej pesë ditësh nga çdo publikim, grupi do të rishikojë të gjithë komentet dhe të sigurohet që të pasqyrohen në të gjithë dokumentet, propozimet dhe hartat. Publikimi i parë do të postohet jo më shumë se një ditë pas dëgjësës publike për marrjen e Nismën.

Ne shpresojmë që të gjitha aktivitetet e tjera do të zbatohet ashtu si janë planifikuar në planin e aktiviteteve, dhe stafi bashkiak do të vazhdojë punën me intensitet në mblehjen e informacioneve dhe të dhënave.

Ne nuk parashikojmë ndonjë risk të menjëhershëm apo kërcënues në përfundimin e detyrës së PPV. Bashkia është e gatshme të përfshihet në proces. Megjithatë, puna do të ndodhë në një vit pas-zgjedhor, që çon drejt krijimit të qeverisë së re qendrore. Mbështetja nga AKPT dhe MZHU mund të duhet për të siguruar që procesi i aplikimit të ndodhë në kohën e parashikuar.

#### 4. Detaje të përputhshmërisë

Gjatë procesit të zbatimit të projektit, pala Konsulente dhe Bashkia Gramsh do të zbatojnë me rigorozitet Ligjin nr, 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe të gjitha aktet nënligjore që rrjedhin prej tij me Vendim të Këshillit të Ministrave. Këto akte nënligjore përfshijnë si më poshtë:

- VKM NR. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i cili përcakton kornizën ligjore në procesin dhe përmbajtjen e PPV si një instrument planifikimi dhe dokument. Kjo rregullore përcakton gjithashtu termat e përdorimit të GIS në hartimin e PPV, duke përfshirë kategoritë e përdorimit të tokës dhe si një nënkategori apo funksion mund të krijohet dhe shtohet në databazën GIS të PPV;
- VKM NR. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i amenduar, i cili përcakton rregullat në disa aspekte që PPV duhet të konsiderojë, si konceptin e nëndarjes/bashkimit e tokës, treguesit e zhvillimit që duhet të mbajë pasaporta e çdo njësie strukturore, përlllogaritjen e disa treguesve specifikë të zhvillimit si Intensiteti, Ksht etj;
- VKM NR. 1096, datë 28.12.2015, “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”

Veç këtyre akteve ligjore dhe nënligjore, grupi konsultues dhe Bashkia do ti referohen një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore të lidhura me: tokën bujqësore, mbrojtjen dhe mundësi të konvertimit të saj, pyjet dhe kullotat, burimeve ujore, brigjeve ujore, zonave ripariene, aktivitetit të afërt ndërtues etj, zonave të mbrojtura natyrore, rregullat për përdorimin dhe mbrojtjen, fashave dhe zonave buffer, kriteret për zgjerim; ujësjellës dhe kanalizime dhe mbetjet urbane; kodet e rrugëve dhe hekurudhave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore; siteve historike dhe monumenteve të kulturës, mbrojtja dhe zonave buferike etj.

PPV është me natyrë gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale për disa sektorë dhe çdo instrument tjetër planifikimi, duke marrë vendime mbi përdorimin e territorit, të cilat ndikojnë në sektorët me dhe zonat me rëndësi lokale/kombëtare. Si rezultat, pala Konsulente dhe Bashkia do të referohen në kornizën e gjërë ligjore për tu siguruar që PPV është ligjërish i pajtueshëm si edhe i mirë ankoruar në strategjinë më të gjërë dhe kornizën e planifikimit të përcaktuar nga dokumentet kombëtare të planifikimit. Në këtë rast, PPK si edhe Plani për Menaxhimin e Basenit të Lumit Seman janë dokumentet kyç kombëtare dhe rajonale që duhen ndjekur.

## **5. Përmbledhje**

Ky raport Fillestar (*Inception*), sjell një kuptim të përbashkët të detyrave që duhen plotësuar gjatë hartimit së PPV. Çdo fazë që do të ndërmerret gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të PPV është shpjeguar shkurtimisht, duke theksuar në këtë mënyrë të gjithë produktet dhe dorëzimet që duhen bërë. Konsulentët janë dakort për të dorzuar çdo produkt në kohë, në përputhje me kontratën dhe planin e aktiviteteve.

Ky dokument gjithashtu sjell edhe një listë të të gjithë aktiviteteve që janë bërë tashmë në kuadër të PPV. Në përfundim, seksioni më poshtë bashkëngjit të gjithë dokumentet, dhe listat me informacion, të cilat janë dorzuar tashmë tek stafi bashkiak, institucionet qeveritare në kuadër të kërkesës për informacion etj.

## **6. Shtojca**

- 1- Plan i Aktiviteteve sipas termave të rakorduara me Bashkinë Gramsh
- 2- Shembull format i letrës zyrtare për institucionet
- 3- Listë për marrjen e të dhënave nga Bashkia Gramsh